

të trajtonte më tutje problematikën në rrjedhë të ngjarjeve: Ç'ndodhi me fitoren sfidë shqiptare në Vijaletin e Kosovës mbi ushtrinë turke, të arritur deri në mesin e gushtit 1912? Përgjigjja në këtë pyetje e zgjidhja e kësaj çështjeje, mbi baza të materializmit dialektik mbetet pjesë vijuese përbërse e kaptinës *Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912*. Bile

kjo kaptinë ndoshta më mirë do t'ishte të titullohej: *Kryengritja (ose lufta) për pavarësinë e Shqipërisë që pasohet pas Luftës për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë*. që pasohet pas *Luftës për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë*.

MUHAMET PIRRAKU

Mate Suić, ANTIČKI GRAD NA ISTOČNOM JADRANU, Sveučilišna naklada „Liber”, Zagreb 1976, 328.

Vepra e *Mate Suić* i t botuar në vitin 1976 për të cilën mund të thuhet se është një kontribut i çmueshëm për studimin e urbanizimit dhe të arkitekturës antike në vendin tonë dhe, siç thotë recensenti i kësaj vepre M. Prelog, është „një punë pionieri”. Libri është i ndarë në 7 kapituj dhe një suplement të veçantë, kurse teksti është ilustruar me 173 fotografi dhe vizatime si dhe 6 tabela.

Në parathënie autori thekson se kjo vepër nuk është historia e qyteteve tona në antikë dhe as historia e arkitekturës antike në bregdetin tonë, por kontribut për sqarimin e disa kapitujve nga kjo lëmë.

Pjesa e parë me titull *Oobjekti dhe metodat e hulumtimit* përfshinë sqarimet mbi kohën dhe territorin e studimit, paraqitjen e qytetit antik si qendër politike, ushtarake, ekonomike etj. Gjithashtu jep burimet për studimin e paleogjenezës, urbanizimit dhe vet urbanizimit të një treve si ato nga *Hekateu i Miletit*, *Pseudo-Skilaku*, *Pseudo-Skimnoja*, *Polibi*, *Livi*, *Straboni*, *Plini Plak*, *Ptolomeu*, *Anonimi i Ravenës* etj, të cilët në veprat e veta shënuan vendbanimet antike dhe komunikimin mes tyre. Autori tregon edhe vlerën e materialit epigrafik ku janë ruajtur të dhënat mbi situatën në qytetet e asaj kohe. Në vazhdim vijon inventari material i qyteteve antike nga faza protourbane dhe ajo urbane e bregdetit tonë, të dhënat mbi gjurmimet që u ndërmorën dhe rezultatet e tyre, si dhe klasifikimi i qyteteve në vendbanimet-qytetet me kontinuitet të pandërprerë, ata me kontinuitet të ndërprerë dhe vendbanimet pa kontinuitet. Pastaj jepet një pasqyrë e zhvillimit me rangje të qyteteve gjer në rangun e kolonisë romake. Në vazhdim autori paraqet regjistrin e qyteteve bregdetare në kohën pararomake si dhe në kohën e hershme romake sipas rangëzimit që e gëzonin ata. Kapitulli merr fund me pasqyrimin e rolit dhe kontributit të arkeologjisë, shkencave teknike, gjeografisë, linguistikës, sociologjisë,

historisë dhe shkencave të tjera në studimin e urbanizimit historik.

Kapitulli i dytë: *Prej fshatit autokton gjer te qyteti autokton-problemet e paleogjenezës*, përmban një pasqyrë të rrjedhës së konsolidimit historik të banorëve të bregdetit (Ilirëve dhe Protoilirëve) si dhe zanafillet e formimit të vendbanimeve (në bazë të lidhjeve fisnore), prej atyre më të thjeshta nëpër *vicus*-a, *pagus*-a prej të cilëve vazhdon zhvillimi i vendbanimeve në bazë të shthurjes së bashkësisë patriarkale. Tani zhvillohet bashkësia — *civitas*, që kishte si qendër *oppidum*-in. Gjatë kohës së ndikimit grek qytetet e bregdetit ruajtën pavarësinë, por duke i pranuar disa risi. Me ardhjen e romakëve këto u bënë pronë romake dhe në saje të këtij fakti në kohën e fundit të Republikës dhe fillimit të Perandorisë-kur u formuan ninitipet-ekzistonin tri lloj tokash: *ager publicus* (prona shtetërore), *ager privatus* (prona private) dhe *ager compascuus* (kullosat dhe pyjet), ndryshe nga sistemi ilir, ku nuk ekzistonte prona e tokave shtetërore, por vetëm ajo private dhe e përbashkët (kullosat dhe pyjet). Në vazhdim autori jep kriteret dhe kategorizimin e vendbanimeve të tipeve *gradina*, *refugium*, *castellum* dhe *oppidum*. Kapitulli mbyllet me trajtimin e çështjes së objekteve brenda vendbanimit, ku thuhet se ekziston mundësia që të ketë pasur shtëpi me plan (bazë) të rrumbullakët dhe jepet tipologjia e shtëpive me bazë katërkëndëshe (pararomake) prej tipit më të thejst me një dhomë gjer te ai me disa dhoma dhe objekte përcjellse të punuara prej guri ose druri, në disa raste edhe në teknikë të përzier. Autori vë në dukje se nga këto tipe u zhvilluan tipet e shtëpive në kohën romake. Gjithashtu në këtë pjesë trajtohet problemi i objekteve publike në vendbanime: shesheve (tregjeve), tempujve, rezervoarëve të ujit, komunikacionit urban si dhe rolit të tyre në sistemin më të vonshëm urban romak në bregdet.

Në kreun e tretë *Në agim të qytetit antik të botës klasike në Adriatikun lindor* bëhet

analiza e qyteteve greke të rregulluara në bazë të traditave greke dhe normave arkitektonike të Hipodamti (shek. V p. e. s.) si dhe analizën e qyteteve romake të rregulluara në traditat etrusko-itale, sipas të cilave qyteti tokësor është krijuar në bazë të ligjeve hyjnore dhe paraqet projeksionin e vendbanimit qiellor të perëndive. Që të dyja këto konceptione janë prodhim i konceptioneve të lashta urbane të zhvilluara në lindje. Diç të re kemi më vonë te Romakët, ku prej formës së *castrumit* (kamp ushtarak) zhvillohet një tip vendbanimi me formë të rregullt që ka rrugët dhe objektet e tjera të rregulluara. Me depërtimin e romakëve në bregdetin tonë fillojnë të zhvillohen vendbanimet sipas konceptonit romak në tradita vendase dhe atyre greke, kështu që zhvillohen vendbanime me formë të rregullt, kurse i tërë territori rreth qytetit është i limituar dhe i ndarë në parcela (pjesë).

Përveç civilëve romakë në qytetërimin antik të bregdetit tonë kanë pasur ndikim edhe njësitë ushtarake, meqenëse rreth fortesave ushtarake zhvilloheshin vendbanimet civile. Autori i jep fund kapitullit me shqyrtimin e strukturës profesionale të këtyre qyteteve, e cila është e përbërë nga studentët, juristët, mjekët, tregtarët pedagogët, retorët etj.

Kapitulli vijues *Realizimet e qytetit të botës klasike në Adriatikun lindor* trajton disa risi në ndërtimtarinë e qyteteve antike në bregdet, siç janë llaçi dhe teknikat e ndryshme të ndërtimit, që u paraqiten si pasojë e përdorimit të llaçit. Këto teknika janë: *opus quadratum*, *opus reticulatum*, *opus mixtum*, *opus incertum*, *opus spicatum*, etj. Në vazhdim trajtohen mënyrat e grumbullimit të mjeteve për ndërtimin e objekteve urbane që kishin formën e tatimeve të ndryshme, dhuratave nga funksionarët publik, dhuratave nga të liruarit, që kandidoheshin për ndonjë funksion etj. si dhe shpenzimet e qyteteve për mirëmbajtjen e objekteve. Pastaj bëhet fjalë për planimetrinë e qyteteve antike bregdetare sidomos mbi shtrirjen e rrugëve kryesore: *kadro* dhe *dekuman* si dhe vendosjen e objekteve publike brenda qyteteve. Këtu dallojmë qytetet e ndërtuara sipas kanuneve arkitektonike itale e poashtu edhe ato të zhvilluara në baza pararomake që nuk kanë trajtë të rregullt.

Prej objekteve arkitektonike në kolonitë dhe municipet e bregdetit që paraqiten nga koha romake janë karakteristike tempujt, në shumicën e rasteve kushtuar treshit hyjnor-kapitolin (Jupiteri, Junona dhe Minerva); forumet që ishin qendër e ngjarjeve në çdo qytet; termat (banjot publike), ku qytetarët

pastroheshin dhe duke u arëgtuar kalonin pasditën; teatrat dhe amfiteatrat, ku zhvilloheshin shfaqjet e ndryshme për shtresat popullore, të cilat ishin të vendosura në ndonjë kënd të qytetit apo edhe jashtë mureve mbrojtëse të qytetit, pastaj objektet memoriale siç janë: portat triumfale, shtatoret e ndryshme etj.; objektet e banimit dhe më në fund objektet komunale (rrugët, kanalizimi, ujësjells) të nevojshme për çdo qytet të asaj kohe. Autori pastaj bën krahasimin e planimetrisë dhe proporcioneve të objekteve arkitektonike romake të qyteteve bregdetare me normat arkitektonike të caktuara nga *Vitruvi*. Më tej bëhet fjalë mbi funksionet e hapsinave dhe objekteve të qyteteve, që i ishin kushtuar kulteve, udhëheqjes municipale, jetës ekonomike, asaj publike si dhe rekreacioneve dhe banimit. Kapitulli përfundon me shqyrtimin e mundësive për rikonstruimin dhe përjetimin e ambientit antik.

Në kreun e pestë trajtohet relacioni qytet-fshat siç vërehet edhe nga titulli: *Raporti qytet-fshat në antikën e hershme* që ka qenë i diktuar nga kushtet objektive dhe kështu fshatrat ishin të vendosura për afërsisht rreth 10 km. larg qytetit, kështu që u mundësonin fshatarëve që brenda ditës të shkojnë në qytet, të kryejnë punë dhe të kthehen në fshat. Rrjeti i rrugëve të rregulluara e lehtësoi këtë gjë. Së pari fshati dhe qyteti ishin të diferencuar, do të thotë ekzistonin vetëm të ashtuquajtura *villa rustica* etj. që nuk kanë të bëjnë as me njërin prej këtyre.

Antagonizmat mes qytetit dhe fshatit antik nuk kanë rëndësi klasore, por kulturore. Ato vërehen edhe ndërmjet fshatit e vendbanimeve rurale. Rezistenca kundër ndikimeve të huaja ishte e dukshme në fshat, por më në fund edhe ky kapituloi nën ndikimet e okupuese.

Kapitulli i para fundit mban titullin: *Inovacionet e antikës së vonshme*. Në kohën e antikës së vonshme ndodhin ngjarjet që ndikojnë në gjendjen e qyteteve. Ngjarje të tilla janë: sulmet e barbarëve, krizat ekonomike, varfëria e shtetit që shkakton varfërinë e qyteteve, gjë që pengon ndërtimin e mëtejshëm, paraqiten idet e reja (krishtërimi bëhet religjion shtetëror), çka ndikojnë në gjendjen e përgjithshme. Rreth shekullit VI e. s. këto vise janë nën sundimin e Gotëve, atëherë kur ndërrohet sistemi i administrimit pason dualizmi kulturo-etnik mes popullsisë të romanizuar ortodokse dhe Gotëve arian. Me dëbimin e Gotëve nga ana e Justinianit këto vise hyjnë nën sundimin e Bizantit dhe përjetojnë fazën e fundit si qytete antike. Ngjarjet e këtilla dhe ndikimet e huaja

kanë shkaktuar një varg risish në ndërtimin e qyteteve, të cilët në antikën e vonshme janë njëkohësisht edhe qytet edhe *kastrum* (kamp ushtarak), tani paraqiten edhe godinat që i bashkojnë karakteristikat e qytetit, pallatit dhe kastrumit njëkohësisht. Me përhapjen e krishtërimit, paraqiten brenda qyteteve komplekset arkitektonike të kushtuara fesë së re, por zakonisht të kufizuara nga komplekset religjioze paganike. Me përfundimin e antikës zhduket edhe qyteti antik, pasi Roma humbi rëndësinë e vet. Në këtë kohë të krishterët konsiderohen si romak, kurse paganët si barbarë. Më vonë trevat e qyteteve antike do të bëhen skenë e ngjarjeve të rëndësishme, duke filluar prej shekullit VII e tutje mëqenëse filloi dyndja e popujve.

Në kapitullin e shtatë: *Trashëgimtaria urbanistike antike* mësojmë mbi shkatërrimin e Salonës, kryeqendrës së Dalmacisë, fatin e së cilës së shpejti e pësuan edhe qytetet e tjera antike të kësaj treve dhe kjo ngjarje merret si fund i antikës. Më tej në bregdetin tonë zhvillohen qytetet mesjetare, të cilët autori i ndan në ata të periudhës gjer në shekullin XI dhe ata pas shek. XI. Në fillim paraqiten kundërshtimet romako-sllave, kurse më vonë për shkak të kushteve kjo shndërrohet në simbiozë që ka lanë gjurma në linguistikë, në art, në arkeologji, në historinë ekonomike dhe politike dhe në urbanizëm.

Në mesjetë në këto treva paraqiten 3 tipa vendbanimesh: *qytetet të trashëguara nga antika, vendbanimet të vendosura si kastrum*, prej të cilëve apo rreth të cilëve zhvillohet *civitas* mesjetare dhe vendbanimet të zhvilluara rreth një casteli që shpeshherë shndërrohen në *civitas*.

Në shek. XI qytetet dalmatine binë nën sundimin e shtetit kroat dhe kështu krijohen kushtet që urbanizimi të zhvillohet në rrethin vendës, kurse qyteti roman të përjetojë sllavizimin. Në fund të kapitullit autori shpreh mendimet se trashëgimia antike mund të jetë edhe sot efikase në zhvillimin e vendbanimeve bregdetare dhe ajo obligon të gjithë ata, të cilëve u është besuar kujdesi, që fryma mesdhetare mos t'i braktisë brigjet tona.

Pas këtij kapitulli pason pashënja e autorit si dhe suplementi i ndarë në tri pjesë, që përfshinë: bibliografinë, burimet dhe regjistrat e emrave dhe ilustrimeve që përfshihen në tekst. Duke e parë librin në tërësi mund të themi se kjo vepër e M. S u i q i t është fryt i punës shumvjeçare dhe do t'i shërbejë të gjithë atyre që merren me antikë, edhe pse do të ishte më mirë sikur të ngërthente një territor më të gjerë pos Dalmacisë në të cilën autori e ka përqendëruar vëmendjen e vet.

NASER FERI